

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot në Tiranë, më datë 27/02/2023, u paraqitën palët si më poshtë:

- **Shoqëria E-MATRIX Sh.p.k**, person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar në regjistrin tregtar në QKB me datë 27/01/2023, me numër unik identifikimi Nipt M31408048A, me seli Rr. "Qemal Stafa", Pallati "Hapsira X", Hyrja 32, Apartamenti 33, Kahar, Yzberisht, Kodi Postar 1050, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm dhe njëherazi Administratori, Z. Francesco Matteucci, lindur me 21/01/1964, ne Corte San Domenico C,1 CAP 56125, Pisa, Itali, shtetas italian identifikuar nepermjet pasaportes me nr YB6607560, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 100 % të kapitalit të shoqërisë **E-MATRIX Sh.p.k** nga këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**".

dhe

**2. Z.SDUIN DAVID TACHON HERNANDEZ**, lindur me 02/10/1990 ne Venezuele, shtetas venezuelian identifikuar nepermjet pasaportes me nr.049700945, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, nga këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**".

### Neni 1

#### Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësit kundrejt blerësit, të **10 % (dhjete përqind)** të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, me një vlerë totale prej **1.000 Euro (njëmijë)**, i konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise me vleren prej **115000 Lek** që Shitësi zotëron në shoqërinë "E-MATRIX " SHPK me nr. NIPT M31408048A

### Neni 2

#### Çmimi i shitjes

Pala Blerëse i paguan Palës Shitëse çmimin e shitjes 1.000 (një mijë) Euro e konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise me vleren prej 115000 Lek për kuotat me vlerë nominale 1.000 (një mijë) Euro ose 115000 Lek që përfaqëson 1 (një kuote pjesë dhe 10% (dhjete përqind) të kapitalit themelitar të Shoqërisë.

Çmimi i Shitjes paguhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.



### Neni 3

#### Detyrimet e Palëve

**3.1** Palet e kesaj kontrate te shitjes se kuotave kane rene dakort si me poshte:

- Shitjen e 1(nje) kuote me perqindje 10% te kapitalit te shoqerise "E-MATRIX" Sh.p.k ne zoterim te **Z. Francesco Matteucci**, tek bleresi **Z. SDUIN DAVID TACHON HERNANDEZ**.
- Çmimi i shitjes se kuotave per te cilen palet kane rene dakort do te jete 1000 Euro e konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise ne vleren prej 115000 lek.
- Shoqeria "E-MATRIX" Sh.p.k, pas nenshkrimit te kesaj kontrate dhe regjistrimit te saj prane QKB do te kete ortaket si me poshte vijon:

**1.Z.FRANCESCO MATTEUCCI**, zoterues i nje kuote ne vleren 90% te kapitalit te Shoqerise.

**2.Z. SDUIN DAVID TACHON HERNANDEZ**, zoterues i nje kuote me vleren 10% te kapitalit te Shoqerise.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesit nuk do jete me ortaku i vetem i kesaj shoqerie, duke bere ne kete menyre bleresin, zoterues te kuotave me 10% te vleres se kapitalit te shoqerise E-MATRIX shpk.

### Neni 4

#### Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë hartohet në 4 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe dhe ate Italiane, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI  
E-MATRIX

FRANCESCO MATTEUCCI



BLERËSI

SDUIN DAVID TACHON HERNANDEZ

